



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 21/20 prot.

Shkodër, më 21.06 .2019

V E N D I M

Nr. 210 , datë 21.06 .2019

**“PËR MIRATIM E HAPJES SË PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, ME  
KOHË TË PLOTË, TË USH-së “**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 18/5, neni 23, pika 1, neni 25, pika 7, neni 35, neni 38/dh, neni 71, neni 72, neni 73, neni 75, Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”, Statuti i USH-së neni 11, pika 8, neni 17, pika 6/f, neni 27, pika 2/b, sipas propozimeve të departamenteve miratuar nga dekanët e fakulteteve përkatëse, Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në mbledhjen e tij të datës 21.06.2019

V E N D O S I

1. Miratimin e hapjes së programeve të reja të studimit, sistemi me kohë të plotë, në fakultetet përkatëse si më poshtë:

**Programe në ciklin e parë të studimeve Bachelor:**

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

- Bachelor në “Gjuhë të huaja të aplikuara për turizëm”, 180 ECTS, periudha e studimit 3-vjeçar 2020-2023

**Programe në ciklin e dytë të studimeve Master:**

Fakulteti Ekonomik

- Master Profesional “Marketing”, 60 ECTS, periudha e studimit 1-vjeçar 2020-2021

Fakulteti i Shkencave të Edukimit

- Master Profesional në “Psikologji Ligjore”, 60 ECTS, periudha e studimit 1-vjeçar 2020-2021
- Master Profesional në “Shërbimet sociale për fëmijët dhe familjen”, 60 ECTS, periudha e studimit 1-vjeçar 2020-2021
- Master Profesional në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”, 60 ECTS, periudha e studimit 1-vjeçar 2020-2021



06.03.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Dekani

Nr. 480 prot.

Shkodër, më 06, 03, 2019

✓ Drejtuar: Zv. Rektorit të USH, Prof. Dr. Gezim Dibra  
Zyrës së Sigurimit të Cilësisë

VENDIM


Nr/6 datë 06/03/2019

Departamentet e Fakultetit Ekonomik kanë vendosur që të fillojnë procesin e akreditimit të programeve të studimit si më poshtë:

1. Bachelor në Administrim-Biznes
2. Bachelor në Financë- Kontabilitet
3. Bachelor në Turizëm
4. Master Profesional në "Menaxhim Financiar, Kontabilitet dhe Kontroll për Administratën Publike"

DEKANI

Prof. As. Dr. Blerta DRAGUŠHA







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

Nr. 1810 Prot

Shkodër, më 30 . 05 . 2019

V E N D I M

Nr. 186 datë 30.05 2019

**"Për miratimin pjesor të detajimit të grantit të pakushtëzuar, viti 2019"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), të Ligjit nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 49 pika 1 germa c, neni 106, VKM-së nr.109, dt.15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të të buxhetit", shkresës së MASR nr.3496, datë 27.03.2019 "Për ndryshimin në planin e buxhetit të vitit 2019", kërkesës së Administratorit nr.1761 datë 24.05.2019 Bordi i Administrimit me vendim qarkullues

**Vendosi:**

- Miratimin pjesor të detajimit të grantit të pakushtëzuar viti 2019 sipas materialit bashkëngjitur.
- Miratimin e financimit të tarifave për akreditim institucional dhe të programeve të studimit nga granti i pakushtëzuar në masën 10.097.772 lekë si më poshtë:

Lloji i shërbimit	Njësia	Tarifa	Vlera
Akreditimi institucional	6 fusha studimi		2,927,369
Akreditim programe studimi bachelor FSHN	6	265585	1,593,510
Akreditim programe studimi bachelor FSHSH	3	265585	796,755
Akreditim programe studimi bachelor FSHE	7	265585	1,859,095
Akreditim programe studimi bachelor FE	3	265585	796,755
Akreditim programe studimi bachelor FGJH	2	265585	531,170



Akreditim programe studimi Master profesional FE	1	204260	204,260
Akreditim programe studimi Master profesional FSHE	2	265585	531,170
Akreditim programe studimi Master i shkencave FSHE	2	428,844	857,688
<b>Totali</b>			<b>10,097,772</b>

- Ngarkohet Administratori i USH-së për zbatim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**



**NAMIK KOPLIKU**

